



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR

Nr. 60/2 Prot., Datë 13.02.2026



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RURAL DHE BUJQËSOR

Nr. 846/2 Prot., Datë 13.02.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AGJENCISË PËR ZHVILLIM RURAL DHE BUJQËSOR
dhe
AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Sot, më 13/2 2026, në Tiranë, nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, institucion publik në varësi të Ministrit të Bujqësisë, me adresë: Rruga "Muhamet Gjollësja" nr. 56, 1023 Tiranë, e krijuar dhe ushtron veprimtarinë e vet, si Agjencia e Pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" dhe sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor e Rural", të ndryshuar, përfaqësuar nga znj. Ardita Kuçi, Drejtor i Përgjithshëm, (në vijim "AZHBR").

dhe

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), institucion publik qendror, në varësi të Kryeministrit me adresë: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr. 3, 1010 Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfaqësuar nga znj. Vilma Tomço, Drejtor Përgjithshëm, (në vijim "ASIG")

Këtu e më poshtë, AZHBR dhe ASIG individualisht referuar si "Palë" dhe së bashku "Palët".

Të vetëdijshëm për nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të frymës së bashkëpunimit në realizimin me sukses dhe cilësi të detyrimeve ligjore të parashikuara nga ligji 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre;

Në mbështetje të proceseve të pozicionit negociues për integrimin evropian të vendit, posaçërisht Klasterin 4 "Agjenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme" dhe Klasterin 5 "Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni";

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit midis Palëve për përdorimin dhe shkëmbimin efektiv të informacionit gjeohapësinor me qëllim krijimin dhe zhvillimin fillestar të Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS), pjesë e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), i cili shërben për të identifikuar dhe menaxhuar zonat bujqësore përmes ortofotove, imazheve satelitore dhe të dhënave gjeohapësinore në përputhje me kërkesat e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE-së.

Ky bashkëpunim synon të:

- Shkëmbejë të dhëna gjeohapësinore për ndërtimin e shtresës referuese të LPIS (ortofoto, kufij parcelash, modele terreni, harta topografike, etj.);
- Përdorë Gjeoportalin Kombëtar për shkëmbimin dhe aksesin e të dhënave;
- Zhvillojë kapacitete teknike përmes trajnimit dhe ndihmës së ofruar nga ASIG;
- Mbështesë AZHBR-në në fazën pilot të zhvillimit të LPIS në Berat dhe në zgjerimin e ardhshëm të sistemit në të gjithë vendin.
- Publikojë në Gjeoportalin Kombëtar të dhënat e sistemit LPIS.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj marrëveshjeje, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

- 2.1 Shkëmbimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore sipas standardeve shtetërore të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në kohë optimale, duke trajtuar me prioritet kërkesat e palëve të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.
- 2.2 Komunikimin sistematik në kuadër të përditësimit të të dhënave gjeohapësinore në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe ofrimin e asistencës në realizimin me sukses të këtij procesi përmes caktimit të personit të kontaktit.
- 2.3 Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, veçanërisht në fushën e trajnimit të stafeve teknike, lidhur me zbatimin e standardeve shtetërore të gjeoinformacionit për temat që lidhen me LPIS dhe IACS.
- 2.4 Pjesëmarrje e ndërsjellë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët me interes në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 3

Angazhime të ASIG

3.1 ASIG angazhohet të vendosë në dispozicion të AZHBR informacionin gjeohapësinor që disponon (ortoimazheri, model digjital terreni, hartë bazë etj.) sipas kërkesave të AZHBR.

3.2 ASIG siguron përditësime periodike të të dhënave gjeohapësinore (ortofoto, model digjital të terrenit, etj.) dhe i ofron AZHBR aksesin e të dhënave në Gjeoportalin Kombëtar.

3.3 ASIG angazhohet të asistojë dhe trajnojë stafin teknik të AZHBR lidhur me përdorimin e ortofotove, gjeoreferencimin, interpretimin e kufijve të parcelave dhe zbatimin standardeve shtetërore të gjeoinformacionit për ndërtimin e sistemit LPIS/IACS, për të cilat AZHBR është autoritet publik përgjegjës.

3.4 ASIG merr përsipër të caktojë një person kontakti, i cili do të adresojë tek strukturat përkatëse brenda ASIG, problematikat e ardhura nga AZHBR lidhur me aksesimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore në funksion të LPIS.

3.5 ASIG angazhohet për pjesëmarrje në takimet e përbashkëta koordinuese me institucione të tjera që disponojnë të dhëna për zhvillimin e sistemit LPIS/IACS, si dhe diskutimin dhe zgjidhjen e çdo çështjeje me interes të përbashkët me AZHBR.

3.6 ASIG angazhohet të udhëzojë AZHBR në procesin e hartimit të specifikimeve teknike në nismat e krijimit të të dhënave dhe sistemeve të informacionit gjeografik që do të ndërmarrë AZHBR, me qëllim konfirmimin e përputhshmërisë me standardet shtetërore.

Neni 4

Angazhime të AZHBR

4.1 AZHBR merr përsipër të mirëmenaxhojë informacionin e venë në dispozicion nga ASIG.

4.2 AZHBR si autoritet publik përgjegjës, merr përsipër organizimin dhe koordinimin e komunikimeve dhe takimeve me institucionet e tjera të përfshira në zhvillimin e projektit të LPIS.

4.3 AZHBR angazhohet të trajtojë me prioritet bashkëpunimin me ASIG, në lidhje me ushtrimin e detyrave funksionale përmes caktimit të një personi kontakti.

4.4 AZHBR angazhohet të informojë dhe ftojë ASIG në çdo aktivitet apo projekt që ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin sa më të mirë të kësaj marrëveshjeje.

4.5 AZHBR angazhohet të informojë paraprakisht ASIG mbi nismat e saj krijuese të të dhënave dhe sistemeve të informacionit gjeografik si dhe të kërkojë konfirmim paraprak të specifikimeve teknike, me qëllim respektimin e standardeve shtetërore.

4.6 AZHBR angazhohet të vërë në dispozicion të dhënat gjeohapësinore të sistemit LPIS dhe çdo sistemi tjetër që lidhet me infrastrukturën bujqësore, me qëllim publikimin e tyre në Gjeoportalin Kombëtar.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

5.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet nga palët pa afat dhe i shtrin efektet nga momenti i nënshkrimit të saj.

5.2 Secila palë mund të zgjidhë marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër, me afat kohor njoftimi 15 dite.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet tyre me mirëkuptim. Në rast të kundërt, zbatohen përcaktimet e legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis organeve publike.

Neni 7

Dispozita përfundimtare

Kjo marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë në dobi të mbarëvajtjes së saj, me propozimin e secilës palë, me afat kohor njoftimi 15 ditë.

7.2 Çdo njoftim dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshime apo shtesa të përmbajtjes së kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore.

7.3 Palët caktojnë personat e kontaktit, të cilët monitorojnë zbatimin e kësaj marrëveshje si dhe i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimin eventuale të tyre.

Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor:

Person Kontakti: Z. Klaudio Çollaku, Drejtor në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit

E-mail: klaudio.collaku@asig.gov.al

Mobile: +355 04 223 6762

Për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural:

Person Kontakti: Znj. Klea Doko, Drejtor në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave

E-mail: klea.doko@azhbr.gov.al

Mobile: +355 04 222 8318

7.4 Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy kopje të njëjta të cilat administrohen nga palët.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet sot më 13 / 02 /2026 dhe fillon menjëherë zbatimin e saj.

PËR
AUTORITETIN SHETETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VILMA TOMÇO



PËR
AGJENCINË PËR ZHVILLIM
BUJQËSOR DHE RURAL

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARDITA KUÇI

